

Në tekstin në vijim janë përkufizimet e tipeve të artikujve dhe udhëzimet për autorët.

PREZANTIM RASTI DHE PREZANTIM RASTESH

Prezantim rasti përfshin një deri pesë pacientë me ç' rast përshkruhet një sëmundje e pazakontë apo një shfaqje e pazakontë e sëmundjes dhe/apo trajtimit. Qëllimi i këtij lloji të artikullit është ofrimi i informatave për komunitetin profesional në lidhje me shfaqjen e sëmundjeve të pazakonta, manifestimet e pazakonta të sëmundjes dhe/apo trajtimit.

Përderisa prezantimi i rastit kufizohet deri në pesë pacientë, prezantimi i një serie rastesh (*case series*) mund të përfshijë numër më të madh pacientësh, zakonisht deri njëzet.

Prezantim rasti kufizohet në 1500 fjalë, 5 figura dhe/apo tabela dhe deri 10 referenca.

Prezantim i një serie rastesh kufizohet në 2000 fjalë, nga 1 figurë dhe/apo tabelë për rast dhe 20 referenca.

Prezantimi i rastit / rasteve përbëhet nga:

- Titulli
- Abstrakti
- Hyrja
- Prezantimi i rastit / rasteve
- Diskutimi dhe përfundimet

EDITORIAL

Ky lloj shkrimi trajton në mënyrë të shkurtër një problematikë të caktuar, bazuar në vështirimet dhe gjetjet e studimeve të tjera. Gjithashtu, shërben për të tërhequr vëmendjen ndaj ngjarjeve në kohët e fundit dhe për ndonjë risi apo tematikë me interes të përgjithshëm për lexuesit. Editoriali ftohet nga redaktori apo shkruhet nga redaktori.

Ky tip artikulli kufizohet në 500 fjalë dhe deri 10 referenca.

LETËR PËR REDAKTORIN

Ky lloj shkrimi trajton çdo temë me interes për lexuesin e revistës duke përfshirë komentet për artikujt e botuar më parë. Këto komente duhet të jenë objektive dhe konstruktive. Ky shkrim mund të përdoret gjithashtu për të shprehur hipoteza të reja dhe për të tërhequr vëmendjen e lexuesve ndaj

çështjeve me interes për temën e caktuar të cilës i referohet. Autori i artikullit të botuar më parë dhe i komentuar nga autori i letrës për redaktorin, zakonisht ftohet të jap një përgjigje me shkrim që definohet si *përgjigje ndaj letrës për redaktorin*.

Ky tip shkrimi kufizohet në 300 fjalë, mund t'i ketë deri 2 figura dhe/apo tabela dhe 5 referenca.

SHËNIM TEKNIK

Ky lloj artikulli, i njohur, gjithashtu, edhe si *inovacion teknik*, përshkruan një teknikë ose procedurë specifike, modifikim të një teknike ekzistuese ose pajisje të re që mund të zbatohet në mjekësi.

Ky tip shkrimi kufizohet në 2000 fjalë, mund t'i ketë deri 10 figura dhe/apo tabela, 1 video (*vegëz online*) dhe deri 20 referenca.

Shënimi teknik përbëhet nga:

- Titulli
- Abstrakti
- Hyrja
- Metodat dhe rezultatet
- Diskutimi dhe përfundimet

RISHIKIM DHE RISHIKIM SISTEMATIK

Rishikimi është një vlerësim kritik i të dhënave shkencore nga studimet e mëparshme të lidhura me një temë të caktuar.

Ky tip artikulli kufizohet në 2000 fjalë dhe 5 figura dhe/apo tabela, kurse numri i referencave nuk është i kufizuar.

Rishikimi sistematik është analizë e detajuar e të gjitha punimeve në dispozicion të një problematike të caktuar.

Ky tip artikulli kufizohet në 3000 fjalë dhe 5 figura dhe/apo tabela kurse numri i referencave nuk është i kufizuar.

Rishikimi përbëhet nga:

- Titulli
- Abstrakti

- Hyrja
- Metodrat
- Rezultatet
- Diskutimi dhe përfundimet

Rishikimi sistematik

- Titulli (*në titull duhet të figurojë fraza – rishikim sistematik*)
- Abstrakti
- Hyrja
- Metodrat
- Rezultatet
- Diskutimi dhe përfundimet

META ANALIZË

Meta analiza është analizë statistike e gjetjeve nga të paktën dy studime referente. Qëllimi i një meta analize është të vlerësojë rezultatet e studimeve të caktuara duke analizuar, krahasuar dhe interpretuar gjetjet e tyre. Gjithashtu, duhet të analizohen kriteret e përfshirjes, madhësia e mostrës, karakteristikat e pjesëmarrësve në studim dhe rezultatet për secilin studim të përfshirë në meta analizë. Për realizimin e meta analizës nuk kërkohet leje nga komiteti etik, por të gjithë autorët inkurajohen të regjistrohen në platformën online Prospero.

Ky tip artikulli kufizohet në 5000 fjalë dhe 5 figura dhe/apo tabela kurse numri i referencave nuk është i kufizuar.

Meta analiza përbëhet nga:

- Titulli (*në titull duhet të figurojë fraza – meta analizë*)
- Abstrakti
- Hyrja
- Metodrat
- Rezultatet
- Diskutimi dhe përfundimet

ARTIKULL ORIGJINAL

Artikulli origjinal është një përshkrim i detajuar i veprimtarisë kërkimore të shkruar nga hulumtuesit që kanë bërë studimin.

Paraprakisht, studimi duhet të sigurojë lejen nga Komisioni për Çështje Etike. Në rast të dizajnit të studimeve klinike të randomizuara apo jo të randomizuara, përpos lejes nga Komisioni për Çështje Etike, regjistrimi i studimit në regjistër përkatës të studimeve klinike është i obligueshëm.

Ky tip artikulli kufizohet në 3000 fjalë dhe 5 figura dhe/apo tabela dhe deri 50 referenca.

Artikulli origjinal përbëhet nga:

- Titulli
- Abstrakti
- Hyrja
- Metodrat
- Rezultatet
- Diskutimi dhe përfundimet

Shënim: Citimi i literaturës duhet të bëhet sipas stilit Vancouver

Autori apo autorët e dorëshkrimit duhet t'i ofrojnë këto të dhëna personale nën titullin e dorëshkrimit:

Një foto personale e formatit të ID (në prapavijë të bardhë)

Titulli akademik (nëse ka)

Emri i Fakultetit (nëse është pedagog)

Emri i Universitetit (nëse është pedagog)

Specializimi (nëse ka)

Institucioni ku punon

Korrespondenca: e-mail adresa

Kontributi i mjekëve të rinj

Më poshtë gjeni kriteret e Redaksisë për publikimet në revistë nga mjekët e rinj.

1. Artikulli nga mjeku i ri apo specializant duhet të ketë ko-autorë një mjek specialist të fushës që shërben në cilësinë e mentorit (autorit korrespondent).
2. Artikulli nga mjeku që është pjesë e grupeve hulumtuese apo studimore.
3. Artikulli nga mjeku i ri apo specializanti që trajton tematika të përgjithshme, si p.sh inteligjenca artificiale (AI) në mjekësi, përparimet dhe inovacionet teknologjike në mjekësi; tema të shëndetit publik; tema nga aspekte sociale që ndërlidhen me shëndetësinë dhe aspekte të përgjithshme të ushtrimit të profesionit, tema që trajtojnë aktivitetet e shkollimit specialistik dhe të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.